FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.23 2004 26 prill

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
	Deklaratë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë lidhur me ngjarjet e ditëve të fundit në Kosovë, datë 18.3.2004	1189
	Deklaratë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë mbi Rezolutën e Kongresit Amerikan, datë 1.4.2004	1189
Dekret nr.4182 datë 25.3.2004	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	1190
Dekret nr.4203 datë 14.4.2004	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	1191
Vendim i KM nr.182, datë 10.4.2004	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal të Zvicrës, për heqjen reciproke të detyrimeve të vizës për mbajtësit e pasaportës diplomatike.....	1191
Vendim i KM nr.185, datë 10.4.2004	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes të disa ngastrave pyjore, pjesë të ekonomisë pyjore Zall-Herr—Priskë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	1194

Vendim i KM nr.187, datë 10.4.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.289, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe përbërjen e këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore".....	1195
Vendim i KM nr.190, datë 10.4.2004	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.550, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave "Për tarifat e shërbimeve që kryhen nga shërbimi i gjendjes civile".....	1195
Vendim i KM nr.191, datë 10.4.2004	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Bajram Currit të mjediseve të degës së mobilizimit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".....	1196
Vendim i KM nr.192, datë 10.4.2004	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Gramshit të mjediseve të ish-Shtëpisë së Ushtarakëve, të ish-shtabit të repartit ushtarak 9920 dhe të degës së mobilizimit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për disa ndryshime në vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".....	1196
Vendim i KM nr.193, datë 10.4.2004	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të degëve të mobilizimit në qytetet Lushnjë dhe Ballsh, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për disa ndryshime në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".....	1197
Vendim i KM nr.194, datë 10.4.2004	Për përparësitë, fushat dhe nivelet e bashkëpunimit të Shërbimit Informativ të Shtetit me shërbimet informative të vendeve të huaja.....	1198
Vendim i KM nr.196, datë 10.4.2004	Për miratimin e kontratës së menaxhimit, ndërmjet ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve të bashkive Durrës, Fier, Lezhë e Sarandë dhe shoqërive Berlin WASSER INTERNATIONAL AG e Berlin WASSER HOLDING AG, për sigurimin e shërbimeve të ujit dhe të kanalizimeve.....	1199
Vendim i KM nr.197, datë 10.4.2004	Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "UFO DENTAL".....	1200
Vendim i KM nr.198, datë 14.4.2004	Për ngritjen dhe funksionimin e Akademisë Diplomatike pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë.....	1200
Vendim i KM nr.200, datë 16.4.2004	Për një shtesë fondi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit për përballimin e pagesës së asistencës teknike për Njësinë e Menaxhimit të Projekteve të Transportit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve	1201

Vendim i KM nr.202, datë 16.4.2004	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit	1202
Vendim i KM nr.203, datë 16.4.2004	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit të ish-magazinave të ish-Qendrës Ekonomike të Arsimit, Sarandë, nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1202
Vendim i KM nr.204, datë 16.4.2004	Për masën dhe kriteret për përfitim paaftësie nga personat me statusin e invalidit të punës	1203
Vendim i KM nr.206, datë 16.4.2004	Për një shtesë në vendimin nr.363, datë 18.7.2002 të Këshillit të Ministrave "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve".....	1204
Vendim i KM nr.207, datë 16.4.2004	Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës "Boo" dhe përcaktimin e organit shtetëror të autorizuar për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit, për ndërtimin e impiantit për përpunimin e mbetjeve të ngurta urbane në qarqet Tiranë-Durrës	1204
Vendim i KM nr.208, datë 16.4.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Armo sh.a.....	1205
Vendim i KM nr.209, datë 16.4.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.300, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave "Për pagesën e vlerës së truallit të shoqërive huamarrëse, për ndërtimin e apartamenteve për kreditorë, që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale"	1206
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Festim Beqiri.....	1206
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Haziz Skeja.....	1206

DEKLARATË
E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
LIDHUR ME NGJARJET E DITËVE TË FUNDIT NË KOSOVË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ndjek me vëmendje të plotë dhe shqetësim të thellë ngjarjet e dhunshme të ditëve të fundit në Kosovë, të cilat çuan në humbjen e jetës së dhjetëra qytetarëve, në lëndimin e qindra të tjerëve dhe djegie e dëme të tjera materiale, të cilat janë pasuri e Kosovës. Kuvendi vlerëson se kjo situatë duhet të kapërcehet sa më parë, në emër të paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit, në emër të interesave të sotëm dhe të së ardhmes euroatlantike të Kosovës dhe të rajonit tonë.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka besim se të gjithë qytetarët e Kosovës do të tregojnë durim, gjakftohtësi, vetëpërmbajtje dhe respektim të të gjitha institucioneve të saj. Gjithashtu ai ka besim se Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me UNMIK-un dhe KFOR-in, do të gjejnë shumë shpejt dhe do të venë para ligjit provokatorët, organizatorët dhe shkaktarët e gjakderdhjes e të shkatërrimeve, kudo qofshin këta, brenda ose jashtë Kosovës, për të kthyer sa më parë në normalitet jetën në vend dhe vazhdimin e proceseve europianizuese dhe integruese në Kosovë. Në këtë kuadër, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vlerëson interesimin dhe kontributin konkret që po japin edhe zyrtarë të lartë të strukturave qendrore europiane dhe euroatlantike.

Njëherësh Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shpreh besimin se edhe partitë politike kosovare dhe faktorët e tjerë shoqërisë, me ndikim në jetën e qytetarëve të Kosovës, do të dëshmojnë pjekurinë e tyre dhe ndjenjën e lartë të përgjegjësisë, për përballimin me mençuri dhe gjakftohtësi të situatës së rëndë, për rikthimin e të gjithëve në punën e përbashkët për demokratizim të mëtejshëm dhe zhvillim të gjithanshëm të Kosovës shumetnike.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shpreh bindjen se edhe të gjithë faktorët politikë e shoqërorë, i gjithë opinioni publik i vendit tonë, do të mbajnë të njëjtin qëndrim, në interes të një Kosove euroatlantike, në interes të paqes dhe të stabilitetit në rajon.

DEKLARATË
E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MBI REZOLUTËN E KONGRESIT AMERIKAN

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përshëndet Rezolutën e Kongresit Amerikan në lidhje me anëtarësimin e tre vendeve të Kartës së Adriatikut, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë, në NATO para vitit 2007, si shprehje të vlerësimit më të lartë për kontributet dhe mbështetjen që këto vende kanë dhënë në forcimin e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare nëpërmjet një procesi të gjithanshëm reformues për ndërtimin e demokracive dhe shtetit të së drejtës në vendet e tyre.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i shpreh falënderime Kongresit Amerikan për mbështetjen që i jep Shqipërisë në rrugën e saj për anëtarësim të plotë në NATO dhe e vlerëson atë mjaft inkurajuese në përpjekjet tona për thellimin e mëtejshëm të reformave dhe plotësimin e të gjitha standardeve të kërkuara, përfshirë edhe reformën në fushën e mbrojtjes.

Kjo Rezolutë është një mbështetje e fuqishme për politikën konstruktive dhe luajale të ndjekur nga Republika e Shqipërisë në ruajtjen, forcimin dhe konsolidimin e sigurisë rajonale, si dhe mbështetjen tonë për luftën kundër terrorizmit, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në operacionet e rëndësishme, të tilla si "Liria e Irakut" dhe në Afganistan.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke vlerësuar mbështetjen e gjithanshme që SHBA i kanë dhënë dhe i japin Shqipërisë në rrugën dhe përpjekjet e saj për integrimin dhe përfshirjen në botën e vlerave të lirisë dhe demokracisë, të mishëruara në strukturat euroatlantike, të riafirmuar me miratimin e kësaj Rezolute, shpreh bindjen se kjo mbështetje edhe në të ardhmen nuk do të na mungojë për të bërë realitet aspiratat e qytetarëve të këtij vendi.

Kjo Rezolutë duhet të na shërbejë që të gjithë së bashku të punojmë pa u lodhur për të thelluar reformat dhe përmushur detyrimet tona, për të kontribuar të gjithë realisht në realizimin e

objektivave madhorë të politikës sonë të jashtme nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës, Kuvend, Qeveri, pozitë dhe opozitë, aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile dhe sipërmarrjes private.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shpreh bindjen dhe angazhimin e tij maksimal për të garantuar përmbushjen në kohë të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga plani i veprimeve për anëtarësim në NATO dhe ato në kuadër të Kartës së Adriatikut, me qëllim që Samiti i ardhshëm t'i hapë rrugën integrimit të plotë në NATO.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përshëndet anëtarësimin në Aleancën më të fuqishme ushtarake të historisë së njerëzimit, NATO, të Bullgarisë, Estonisë, Letonisë, Lituanisë, Rumanisë, Sllovakisë dhe Sllovenisë dhe vlerëson mirëseardhjen e ngrohtë që Kongresi Amerikan rezervoi për ta, duke shpresuar që në një të ardhme shumë të shpejtë ky vlerësim i merituar do t'i rezervohet edhe Shqipërisë.

DEKRET
Nr.4182, datë 25.3.2004

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Zenel Islam Sulejmani
2. Hajrie Shefqet Schieder (Beka)
3. Ali Isuf Naqi
4. Drita Rexhep Karami (Lushka)
5. Eridan Edip Pilku
6. Erxhi Aurora Eridan Pilku
7. Edita Sali Pilku (Sokoli)
8. Migena Eridan Pilku
9. Sara Eridan Pilku
10. Thanas Miço Bele
11. Lirim Bajram Haxhia
12. Alkeda Jorgo Paskali (Qyra)
13. Xhek Artur Paskali
14. Xhensi Artur Paskali
15. Xhakonda Artur Paskali
16. Evisa Abdurahman Deutsch (Pilkati)
17. Kelvin Selim Spanjolli
18. Stela Viktor Keck (Sokoli)
19. Artur Fatmir Zenga
20. Shkëlqim Skënder Lushnja
21. Alkida Skënder Lushnja
22. Zamiel Kadri Ferri
23. Artur Halit Mara
24. Roland Dhimitri Matraku
25. Bardhul Musa Shehu
26. Liljana Xhafer Shehu (Shkëmbi)
27. Flora Tomor Berikoven (Spaho)
28. Kevin Hans Jürgen Berikoven
29. Rexhep Haki Ademi
30. Xhesika Rexhep Ademi
31. Nexhmije Ramazan Ademi (Maloku)
32. Xheni Rexhep Ademi
33. Muharrem Gani Rreshka
34. Julia Muharrem Rreshka
35. Ludmilla Isa Rreshka (Hoxha)
36. Huanito Muharrem Rreshka
37. Arjan Nikoll Tuci
38. Ariana Arjan Tuci
39. Janett Arjan Tuci
40. Manuela Qerim Islami (Sherifi)
41. Engjellushe Hajdar Begaj (Masha)
42. Anila Ismet Graf (Dauti)
43. Kleopatra Koço Çiçi
44. Hamit Tare Shkëmbi
45. Ilir Josif Taja
46. Spartak Fatmir Rushiti
47. Selina Spartak Rushiti
48. Romina Spartak Rushiti
49. Zhulja Meto Dauti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4203, datë 14.4.2004

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 9 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Hasan Adem Mulliqi
2. Halim Abdyl Krasniqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.182, datë 10.4.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL TË ZVICRËS, PËR HEQJEN RECIPROKE TË DETYRIMEVE TË VIZËS PËR MBAJTËSIT E PASAPORTËS DIPLOMATIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal të Zvicrës, për heqjen reciproke të detyrimeve të vizës për mbajtësit e pasaportës diplomatike.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL TË ZVICRËS PËR HEQJEN RECIPROKE TË DETYRIMEVE TË VIZËS PËR MBAJTËSIT E PASAPORTËS DIPLOMATIKE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli Federal i Zvicrës, të quajtura më poshtë "Palë Kontraktuese",

me qëllim për të lehtësuar qarkullimin ndërmjet dy shteteve të personave mbajtës të pasaportës diplomatike;

me qëllim për të forcuar në mënyrë reciproke një bashkëpunim besimi dhe solidariteti;

duke pasur parasysh Marrëveshjen e 29 shkurtit 2000 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal të Zvicrës mbi ripranimin e personave në situatë të parregullt,

kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

Neni 1

Shtetasit e të dyja Palëve Kontraktuese, që janë mbajtës të një pasaporte diplomatike kombëtare të vlefshme dhe shkojnë me mision zyrtar në shtetin tjetër me cilësinë e anëtarit të përfaqësisë diplomatike ose konsullore të vendit të tyre ose si bashkëpunëtorë pranë organizatave ndërkombëtare, janë të liruar nga detyrimet e vizës gjatë kohëzgjatjes së funksionit të tyre. Dërgimi i tyre në mision dhe funksionet e tyre do t'i bëhet e njohur paraprakisht Palës tjetër Kontraktuese në rrugë diplomatike. Shteti pritës do t'u lëshojë atyre një kartë identiteti. Kjo dispozitë është e vlefshme gjithashtu dhe për anëtarët e familjeve të tyre që jetojnë bashkë me ta dhe kanë një pasaportë zyrtare ose të thjeshtë të vlefshme.

Neni 2

Shtetasit e të dyja Palëve Kontraktuese që janë mbajtës të një pasaporte diplomatike kombëtare të vlefshme, por që nuk janë as anëtarë të një përfaqësie diplomatike ose konsullore të shtetit të tyre, as përfaqësues të shtetit të tyre pranë organizatave ndërkombëtare në shtetin tjetër, nuk kanë nevojë për vizë për të hyrë në shtetin tjetër, për të qëndruar atje deri në 90 ditë dhe për të dalë prej andej, në rastet kur nuk ushtrojnë atje aktivitet të pavarur fitimi ose me pagesë.

Neni 3

Pavarësisht nga lloji i pasaportës së tyre, shtetasit e të dyja Palëve Kontraktuese që kanë banimin e tyre në vendin e Palës tjetër Kontraktuese mund të kthehen atje pa vizë për aq kohë sa ata kanë një autorizim qëndrimi të vlefshëm.

Neni 4

Palët Kontraktuese do të transmetojnë në mënyrë reciproke specimenët e pasaportave të tyre, si dhe informacione të sakta lidhur me përdorimin e tyre. Në rast të daljes së pasaportave të reja, të dyja Palët Kontraktuese do të informohen në rrugë diplomatike, mundësisht 30 ditë para vënies së tyre në qarkullim dhe do t'i dorëzojnë njëra-tjetrës specimenet korresponduese. Ato do të informojnë njëra-tjetrën mbi kushtet e hyrjes që zbatohen për qytetarët e shteteve të treta.

Neni 5

Kjo Marrëveshje nuk i çliron shtetasit e njërës Palë Kontraktuese nga detyrimet për t'u përshtatur, gjatë hyrjes dhe gjatë qëndrimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, me ligjet dhe rregullat e tjera ligjore në fuqi.

Neni 6

Autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese kanë të drejtën për të refuzuar hyrjen apo qëndrimin e shtetasve të shtetit tjetër që mund të vinin në rrezik rendin, sigurinë ose shëndetin publik, ose kur prania e tyre në vend është e paligjshme.

Neni 7

Të dhënat personale që duhet të komunikohen në realizimin e kësaj Marrëveshjeje janë të përmbledhura, të përpunuara dhe të mbrojtura konform së drejtës së brendshme. Në mënyrë të veçantë, parimet e mëposhtme duhet të respektohen:

a) Pala Kontraktuese kërkuese përdor të dhënat personale të komunikuara vetëm për qëllimet e parashikuara dhe me kushtet e përcaktuara nga Pala Kontraktuese që i ka komunikuar ato.

b) Pala Kontraktuese kërkuese informon, sipas kërkesës, Palën tjetër Kontraktuese mbi përdorimin e të dhënave personale që kjo e fundit i ka komunikuar.

c) Të dhënat personale mund të komunikohen dhe të përpunohen vetëm nga autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Të dhënat personale mund t'u komunikohen personave të tjerë vetëm me autorizimin e shkruar paraprakisht nga Pala Kontraktuese që i ka komunikuar ato.

d) Pala Kontraktuese pritëse është e detyruar të sigurojë saktësinë e të dhënave që transmetohen, si dhe nevojën dhe mjaftueshmërinë me qëllimin e ndjekur nëpërmjet komunikimit. Format e ndalimit të transmetimit, parashikuar nga e drejta e brendshme, duhet të respektohen. Në rast se konstatohen se të dhënat e transmetuara janë të pasakta ose transmetimi është jo i qartë, përfituesi duhet të njoftohet menjëherë. Ai duhet të merret me rregullimin ose me asgjësimin e nevojshëm të tyre.

e) Me kërkesën e tij çdo person do të informohet mbi të dhënat personale që i përkasin atij dhe mbi përdorimin për të cilin janë parashikuar ato, në përputhje me të drejtën e Palës Kontraktuese nga ku është marrë informacioni.

f) Të dhënat personale të transmetuara do të ruhen për aq kohë sa e kërkon qëllimi për të cilin ato janë komunikuar. Kontrolli i përpunimit dhe i përdorimit të këtyre të dhënave sigurohet në përputhje me të drejtën e brendshme të çdo Pale Kontraktuese.

g) Çdo Palë Kontraktuese është e detyruar të mbrojë të dhënat personale të transmetuara kundër hyrjes së paautorizuar, modifikimeve abuzive ose komunikimit të paautorizuar. Në të gjitha rastet, të dhënat e transmetuara do të përfitojnë një nivel mbrojtje të njëjtë me atë që gëzojnë të dhënat e së njëjtës natyrë në legjislacionin e Palës Kontraktuese kërkuese.

Neni 8

Vështirësitë gjatë zbatimit ose interpretimit të kësaj Marrëveshjeje duhet të zgjidhen ndërmjet autoriteteve kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese, me konsultime reciproke. Mosmarrëveshjet, lidhur me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen ndërmjet Palëve Kontraktuese në rrugë diplomatike.

Neni 9

Çdo Palë Kontraktuese për arsye të rendit, shëndetit dhe sigurimit publik, mund të pezullojë zbatimin e të gjitha dispozitave ose të një pjese të kësaj Marrëveshjeje. Pezullimi dhe hyrja përsëri në fuqi do t'i njoftohet menjëherë Palës tjetër Kontraktuese në rrugë diplomatike dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë pas marrjes së njoftimit.

Neni 10

Kjo Marrëveshje i shtrin efektet e saj edhe në territorin e Principatës së Lihtenshtajnit dhe shtetasve të saj.

Neni 11

Kjo Marrëveshje ka afat kohor të pacaktuar. Ajo mund të denoncohet në çdo kohë mesatarisht në një afat prej 90 ditësh. Denoncimi duhet t'i njoftohet Palës tjetër Kontraktuese në rrugë diplomatike.

Neni 12

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë mbas komunikimit reciprok në rrugë diplomatike se procedurat e brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur.

Bërë në Tiranë, më 19 mars 2004, në dy kopje, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën frënge, që të dyja me vlerë të barabartë.

VENDIM
Nr.185, datë 10.4.2004

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES TË DISA NGASTRAVE PYJORE, PJESË TË EKONOMISË PYJORE ZALL-HERR —PRISKË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe të nenit 7 të ligjit nr.7623, datë 13.10.1992 "Për pyjet dhe Policinë e Shërbimit Pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngastrat pyjore me numrat rendorë nga 59-82 dhe me sipërfaqe 693 ha, pjesë të ekonomisë pyjore Zall-Herr—Priskë, të kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për t'u përdorur për ngritjen e mjedisit stërvitor qendror të Komandës së Forcave Tokësore.

2. Ngastrat pyjore të përcaktuara në pikën 1 të përfshihen në pronën nr.157, me emërtimin "brigada e tankeve", komuna Zall-Herr, Tiranë të listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Komanda e Forcave Tokësore dhe Shoqata e Përdorimit të Ujit, Zall-Herr të lidhin marrëveshje të përbashkët për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ujëmbledhësve nr.1 dhe nr.2, në Zall-Herr, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 6.8 ha, të cilat përfshihen në territorin ku do të ngrihet mjedisi stërvitor qendror i kësaj komande.

4. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.187, datë 10.4.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.289, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET DHE PËRBËRJEN E KËSHILLAVE MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE ANONIME SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.8885, datë 22.4.2002 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare"", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.289, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Në pikën 7 fjalët "Këshilli i Ministrave..." zëvendësohen me "Kryeministri...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.190, datë 10.4.2004

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR.550, DATË 1.8.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYHEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 67 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile" dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën "Lista e tarifave të shërbimit të zyrave të gjendjes civile", që i bashkëlidhet vendimit nr.550, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Certifikatë për lidhje martese në gjuhë të huaja 200 lekë.".

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

"4. Certifikatë lindjeje në gjuhë të huaja 200 lekë.

5. Certifikatë martese në gjuhë të huaja 200 lekë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.191, datë 10.4.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË BAJRAM CURRIT TË MJEDISEVE TË DEGËS SË MOBILIZIMIT, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja "c", 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e degës së mobilizimit në qytetin e Bajram Currit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, t'i kalojnë në pronësi bashkisë së Bajram Currit, për t'u përdorur si kopësht dhe çerdhe për fëmijët.
2. Prona me numër rendor 500, "Dega e mobilizimit" në Bajram Curri, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Bashkisë së qytetit Bajram Curri i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryetari i bashkisë së Bajram Currit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.192, datë 10.4.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË GRAMSHIT TË MJEDISEVE TË ISH-SHTËPISË SË USHTARAKËVE, TË ISH-SHTABIT TË REPARTIT USHTARAK 9920 DHE TË DEGËS SË MOBILIZIMIT, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIT NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja "c", 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-Shtëpisë së Ushtarakëve dhe të ish-shtabit të repartit ushtarak 9920 në Gramsh, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Gramshit, për strehim dhe kthim në fond banese.

2. Mjediset e degës së mobilizimit në Gramsh, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, t'i kalojnë në pronësi bashkisë së Gramshit, për t'u përdorur për nevojat kulturore-shoqërore të këtij qyteti.

3. Pronat me numrat rendorë 342, "Ish-Shtëpia e Ushtarakëve", 340, "Ish-shtabi i repartit ushtarak 9920" dhe 341, "Dega e mobilizimit" në Gramsh, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

4. Bashkisë së Gramshit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, t'i tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryetari i bashkisë së Gramshit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.193, datë 10.4.2004

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË DEGËVE TË MOBILIZIMIT NË QYTETET LUSHNJË DHE BALLSH, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "c" të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediseve të degëve të mobilizimit në Lushnjë dhe Ballsh t'u ndryshojë përgjegjësia e administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te prefekti i qarkut të Fierit, për t'u përdorur për sistemin e sektorëve të PMNZSH-së, të Lushnjës dhe Mallakastrës.

2. Pronat me numrat rendorë 862, "Dega e mobilizimit" në Lushnjë dhe 949, "Dega e mobilizimit" në Ballsh, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Prefektit të qarkut të Fierit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, t'i tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, prefekti i qarkut të Fierit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.194, datë 10.4.2004

PËR PËRPARËSITË, FUSHAT DHE NIVELET E BASHKËPUNIMIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT ME SHËRBIMET INFORMATIVE TË VENDEVE TË HUAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 16 të ligjit nr.8391, datë 28.10.1998 "Për Shërbimin Informativ Kombëtar", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi Informativ i Shtetit, për realizimin e detyrave për sigurimin kombëtar, bashkëpunon me shërbimet informative të vendeve të huaja, në përputhje me parimet e respektimit e të besimit të ndërsjellë, të barazisë dhe respektimit të pavarësisë.

2. Bashkëpunimi realizohet në funksion të:

a) Përparësive, ku përfshihen:

- çështjet që kanë lidhje, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë;
- çështjet e diktuara nga siguria rajonale;
- detyrimet që lindin nga aleancat strategjike të shtetit.

b) Fushave të bashkëpunimit që janë:

- shkëmbimi i të dhënave;
- mbështetja logjistike;
- shkëmbimi i përvojave dhe trajnimet;
- modernizimi i segmenteve tekniko-shkencore;
- kryerja e detyrave dhe e operacioneve të përbashkëta;
- përdorimi i ndërsjellë i burimeve për zgjidhjen e detyrave të përbashkëta, brenda dhe jashtë vendit.

c) Nivelit:

- Formal - Në këtë rast Shërbimi Informativ i Shtetit mban thjesht kontakte njohjeje me shërbimin e vendit tjetër, ku mund të paraqiten punonjësit e tyre zyrtarë të akreditуar në të dy vendet. Në këtë nivel ndërmjet shërbimeve nuk shkëmbehen të dhëna, si dhe nuk ndërmerren veprime të përbashkëta.
- Normal - Në këtë rast Shërbimi Informativ i Shtetit shkëmben të dhëna me shërbimin informativ të huaj dhe kryen veprime të përbashkëta, në funksion të përparësive, të miratuara nga Kryeministri. Në këtë nivel dy vendet ruajnë raporte dhe marrëdhënie të mira politike.
- Optimal - Në këtë rast Shërbimi Informativ i Shtetit bashkëpunon ngushtë me shërbimin informativ të huaj, në të gjitha fushat, për realizimin e përparësive, duke ndërmarrë e duke kryer edhe operacione të përbashkëta.

Gjatë bashkëpunimit me shërbimet informative të huaja ruhet identiteti i burimeve të të dhënave.

3. Përparësitë, fushat dhe nivelet e bashkëpunimit, me secilin shërbim informativ të huaj, miratohen nga Kryeministri, me propozimin e drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

4. Në rastet kur, për zgjidhjen e detyrave të përbashkëta, është i domosdoshëm dërgimi jashtë Republikës së Shqipërisë i burimit të Shërbimi Informativ të Shtetit, ai shoqërohet, drejtohet dhe kontrollohet nga inspektori, që e mban në lidhje. Kur është e nevojshme inspektori bashkëpunon dhe mbështetet edhe nga inspektorë të tjerë të këtij shërbimi.

5. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit krahas njoftimit të rregullt, një herë në gjashtë muaj, i dërgon Kryeministrit një raport, me shkrim, për përparësitë, nivelet dhe fushat e bashkëpunimit me shërbimet informative të huaja.

6. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit, nëpërmjet udhëzimeve, përcakton:

a) procedurat që do të zbatojnë njësitë dhe punonjësit, për bashkëpunimin dhe shërbimet informative të huaja;

b) dokumentacionin që do të përdoret për realizimin e këtij bashkëpunimi;

c) rregullat për grumbullimin, ruajtjen, administrimin dhe shpërndarjen e dokumentacionit, që prodhohet nga ky bashkëpunim;

ç) rregullat për marrjen, për ruajtjen dhe për administrimin e vlerave, materiale dhe monetare, që rrjedhin nga bashkëpunimi me shërbimet informative të huaja;

d) procedurat e përdorimit të ndërsjellë të burimeve për zgjidhjen e çështjeve të përbashkëta, brenda dhe jashtë vendit;

dh) procedurat për kryerjen e detyrave dhe të operacioneve të përbashkëta.

7. Ngarkohet drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.196, datë 10.4.2004

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË MENAXHIMIT NDËRMJET NDËRMARRJEVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE TË BASHKIVE DURRËS, FIER, LEZHË E SARANDË DHE SHOQËRIVE BERLIN WASSER INTERNATIONAL AG E BERLIN WASSER HOLDING AG, PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE TË UJIT DHE TË KANALIZIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” dhe të neneve 10 pika 3/1 shkronja “a” dhe 72 pika 5/1 shkronja “a” të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, të Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së menaxhimit, ndërmjet ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve të bashkive Durrës, Fier, Lezhë e Sarandë dhe shoqërive Berlin Wasser International AG e Berlin Wassert Holding AG, për sigurimin e shërbimeve të ujit dhe të kanalizimeve.

2. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, me cilësinë e Organit Shtetëror të Autorizuar, të kryejnë transferimin e së drejtës së përfaqësimit të pronarit për pronën shtetërore te organet e qeverisjes vendore, nëpërmjet akteve të dorëzimit të objektit të kësaj kontrate.

3. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit, Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.197, datë 10.4.2004

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "UFO DENTAL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "Ufo Dental", sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin nr.156, datë 22.3.2001 të Këshillit të Ministrave "Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë".
2. Shkolla e lartë jopublike "Ufo Dental", të jetë e nivelit universitar, me degën e vetme stomatologji.
3. Kjo shkollë ta zhvillojë veprimtarinë në mjediset e veta, me adresë: Rruga "Kajo Karafili", nr.22, Tiranë.
4 . Kohëzgjatja e kursit të studimit të jetë 4 vjet.
5. Titulli i diplomës, që jepet në përfundim të studimeve të plota universitare, është "Mjek stomatolog i përgjithshëm".
6. Ngarkohet Ministri i Arsimit dhe i Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit të njohjes së kursit të studimit dhe për zbatimin e ligjshmërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.198, datë 14.4.2004

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E AKADEMISË DIPLOMATIKE PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Akademisë Diplomatike, në varësi të Ministrit të Punëve të Jashtme.
2. Akademia Diplomatike është qendra e trajnimit, kualifikimit dhe rikualifikimit të të gjithë punonjësve të shërbimit me jashtë, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe janë pjesë e personelit diplomatik.
3. Akademia Diplomatike pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të hartojë programet arsimore të trajnimit, kualifikimit dhe rikualifikimit të punonjësve, që përbëjnë personelin diplomatik, si dhe të drejtojë, të bashkërendojë e të administrojë kurset e përgatitjes së diplomatëve.
4. Programi arsimor i trajnimeve, kualifikimeve dhe rikualifikimeve të Akademisë Diplomatike miratohet nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe mbarëvajtja e tij kontrollohet nga këshilli drejtues.

5. Akademia Diplomatike ka strukturë funksionale të drejtuar nga drejtori i Akademisë Diplomatike, personeli i së cilës gëzon statusin, gradën dhe trajtimin financiar të punonjësve të shërbimit me jashtë.

6. Drejtori dhe personeli i Akademisë Diplomatike emërohen në përputhje me ligjin nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë".

7. Pranë Akademisë Diplomatike veprojnë këshilli drejtues dhe këshilli shkencor.

a) Këshilli drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, duke përfshirë edhe drejtorin e Akademisë. Këshilli kryesohet nga Ministri i Punëve të Jashtme. Këshilli drejtues harton programin vjetor të veprimtarisë së Akademisë, afatet kohore të kurseve dhe lektorët.

b) Këshilli shkencor përbëhet nga 7 anëtarë. Në të mund të përfshihen edhe specialistë të huaj, në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Këshilli shkencor bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në kurs, analizon nevojat formuese, projekton kursin, siguron burimet njerëzore dhe materiale, bën programimin didaktik dhe realizimin e kursit.

8. Anëtarët e këshillit drejtues dhe të këshillit shkencor emërohen nga Ministri i Punëve të Jashtme, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

9. Veprimtaria e Akademisë Diplomatike mbështetet në rregulloren e posaçme, të hartuar nga këshilli shkencor e nga këshilli drejtues dhe të miratuar nga Ministri i Punëve të Jashtme, në përputhje me legjislacionin përkatës, që rregullon veprimtarinë e institucioneve të kësaj natyre në Republikën e Shqipërisë.

10. Personeli i Akademisë Diplomatike përbëhet nga një staf prej 4 personash: drejtori i Akademisë, sekretari shkencor (shef sektori) dhe dy specialistë.

11. Efektet financiare, në shumën 3 919 626 (tre milionë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë, për pagat e personelit të Akademisë Diplomatike, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

12. Ngarkohet Ministri i Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.200, datë 16.4.2004

PËR NJË SHTESË FONDI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT PËR PËRBALLIMIN E PAGESËS SË ASISTENCËS TEKNIKE PËR NJËSINË E MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE TË TRANSPORTIT DHE DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t'i shtohet fondi prej 46 800 000 (dyzet e gjashtë milionë e tetëqind mijë) lekësh, për përballimin e pagesës së asistencës teknike për Njësinë e Menaxhimit të Projekteve të Transportit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për periudhën shkurt-shtator 2004.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.202, datë 16.4.2004

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Financave , Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimit Informativ të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t'i shtohen fondet:
- 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë në zërin "602-Mallra dhe shërbime";
- 8 000 000 (tetë milionë) lekë në zërin "231- Shpenzime kapitale të trupëzuara".
2. Këto fonde të përballohn nga fondi i rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.203, datë 16.4.2004

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT TË ISH-MAGAZINAVE TË ISH-QENDRËS EKONOMIKE TË ARSIMIT, SARANDË, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit të ish-magazinave të ish-Qendrës Ekonomike të Arsimit, Sarandë, nga Minisria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.204, datë 16.4.2004

PËR MASËN DHE KRITERET PËR PËRFITIM PAAFTËSIE NGA PERSONAT ME STATUSIN E INVALIDIT TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Invalidët e punës, të cilët kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet, në institucionet shtetërore, ish-kooperativat bujqësore, repartet ushtarake, si dhe ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, që vuajnë nga sëmundje profesionale a janë aksidentuar në punë apo kanë sëmundje të ndryshme, e që marrin pension invaliditeti, në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ose të ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", të ndryshuar, përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, nga fondi i pagesës së personave me aftësi të kufizuar, si më poshtë vijon:

a) Personat që përfitojnë pension invaliditeti të plotë 3 000 lekë
b) Personat që përfitojnë pension invaliditeti të pjesshëm 2 000 lekë

2. Invalidët, të cilët përfitojnë sipas shkronjave "a", "b" e "c" të pikës 2 të vendimit nr.381, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave "Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit"", të ndryshuar, përfitojnë një shtesë mujore të barabartë me diferencën ndërmjet masës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi si përfitim paaftësie dhe të përfitimit të përcaktuar në vendimin nr.381, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave.

3. Kjo shtesë u jepet invalidëve të punës pavarësisht nga të ardhurat e tjera që përfitojnë nga programet e mbrojtjes sociale dhe nuk llogaritet në të ardhurat e familjes. Ajo përfitohet edhe pas mbushjes së moshës për pension pleqërie.

4. Organet e sigurimeve shoqërore dërgojnë zyrtarisht kopje të vërtetimeve të KMCAP-it për paaftësinë në punë, listën e përfituesve dhe masën e përfitimit, sipas vendimit nr.381, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, pranë zyrave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Këto zyra përgatisin listën e përfituesve dhe urdhërpagesën, të cilat i dërgojnë në zyrat e njësive të pushtetit vendor ku invalidët kanë vendbanimin.

5. Instituti i Sigurimeve Shoqërore përgatit vërtetimin tip të KMCAP-it për paaftësinë në punë, të parashikuar në pikën 4 të këtij vendimi.

6. Pagesa tërhiqet nga invalidi çdo muaj pranë zyrave të njësive të pushtetit vendor, duke paraqitur dokumentin e identifikimit.

7. Ngarkohet Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shkurt 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.206, datë 16.4.2004

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.363, DATË 18.7.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR VENDOSJEN E OPONENCËS TEKNIKE PËR PROJEKTET E NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të neneve 124 dhe 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.363, datë 18.7.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhet kjo shtesë:

Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

"4/1. Tarifat për oponencën teknike të projekteve të jenë sipas lidhjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

TARIFAT PËR OPONENCËN TEKNIKE PËR PROJEKTET E NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE

Tarifat për oponencën teknike për projektet e ndërtimit të objekteve i referohen tarifës në përqindje të projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, si më poshtë:

Kushtimi (milion/lekë)	Tarifa (në %)
100,00	7.0
150,00	6.5
200,00	6.0
300,00	5.5
Mbi 300,00	5.0

VENDIM
Nr.207, datë 16.4.2004

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCESION TË FORMËS "BOO" DHE PËRCAKTIMIN E ORGANIT SHTETËROR TË AUTORIZUAR PËR PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT PËR PËRPUNIMIN E MBETJEVE TË NGURTA URBANE NË QARQET TIRANË-DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pika 5,5 dhe 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për dhënien me koncesion të përpunimit të mbetjeve të ngurta urbane, në qarqet Tiranë-Durrës, me shoqëritë e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi mbi propozimin e ofertave të pakërkuara.

2. Koncesioni të jetë i formës "BOO" (ndërtim-pronësi-shfrytëzim).

3. Organi shtetëror i autorizuar (OSHA) për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës të jenë Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit.

4. Organi shtetëror i autorizuar bën vlerësimin e ofertave të paraqitura nga shoqëritë e mësipërme, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

- programi i investimeve;
- skema e financimit të koncesionit dhe ajo e financimit të veprimtarisë së koncesionarit;
- kriteret dhe parametrat shoqërore, ekonomike dhe mjedisore;
- kërkesa për lehtësi dhe foma mbështetjeje të veçanta nga Këshilli i Ministrave;
- këkesa të veçanta për sektorin e përpunimit të mbetjeve urbane.

5. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi nr.341, datë 11.7.2002 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e organeve shtetërore të autorizuara për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit, për përpunimin e mbetjeve të ngurta urbane, të qarqeve Tiranë-Durrës", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.208, datë 16.4.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ARMO, SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ARMO sh.a.

Lista përbëhet nga 140 (njëqind e dyzet) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.209, datë 16.4.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.300, DATË 12.5.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGESËN E VLERËS SË TRUALLIT TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE, PËR NDËRTIMIN E APARTAMENTEVE PËR KREDITORË, QË KANË HUMBUR BANESAT NGA RËNIA E SKEMAVE PIRAMIDALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 15 të ligjit nr.8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurën e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë" dhe neneve të 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.300, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim:
Në pikën 2, shifra "…24 360 m^2 …" bëhet "… 20 360 m^2…".
2. Ngarkohet Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KËRKESË

Shtetësja Razije Beqiri kërkon shpalljen të zhdukur të djalit të saj Festim Beqiri.

KËRKUESE
Razije Beqiri

KËRKESË

Shtetasi Selim Skeja kërkon shpalljen të zhdukur të djalit të tij Haziz Skeja.

KËRKUESI
Selim Skeja

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
  Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 26.4.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë